



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr.75/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, për shkak të vendosjes së posterave mbi shenja publike, në seancën e panelit të mbajtur me 30.04.2012, mori këtë:

#### V E N D I M

**MIRATOHET** ankesa si e bazuar e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Ferizaj, ashtu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj i shqiptohet dënim i më gjobë në vlerë prej 2100 (dymijë e njëqind) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit të këtij vendimi, për të u dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës

#### Arsyetim

PZAP, ka pranuar një ankesë më datë 28.04.2012, nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendohet se anëtarët e subjektit politik PDK, me datën 28.04.2012, në Rrugën “Ismet Ramadani”, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Ferizajt, kanë bërë shkelje të Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009 të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, neni 3 paragrafi 1 pika (b), si dhe neni 33 paragrafi 1 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), në atë mënyrë që sipas parashtruesit të ankesës është bërë vendosja e posterëve të kandidatit të subjektit politik të PDK-së, mbi shenja publike për qytetarë.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur disa fotografi si dëshmi, të kandidatit për kryetar të komunës së Ferizajt, nga radhët e subjektit politik të PDK-së, të vendosura mbi shenja publike për qytetarë.

## Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:

PZAP-i, e informoi subjektin politik PDK, më datë 28.04.2012, në mënyrë elektronike për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 29.04.2012, në ora 12:00. PZAP-i, pranoi përgjigje në ankesë, nga subjekti politik PDK, brenda afatit të përcaktuar në të cilën theksohet se: Duke u bazuar në kërkesën për përgjigje me numrin e Ref.No.ZKS/PZAP-i, të datës 28.04.2012, paraqesim përgjigje në ankesë, ndaj ankesës së subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje të datës 28.04.2012, ku subjekti politik PDK, potencon, se pretendimet e subjektit politik LVV, janë të pabazuara, për arsy se pas verifikimit të fakteve të paraqitura në ankesën e subjektit politik të LVV-së, subjekti politik PDK, konstaton se posteri i kandidatit për kryetar Komune të subjektit politik PDK i paraqitur si provë në ankesën e LVV-së, nuk i përgjigjet formatit të posterave të subjektit politik PDK, si dhe me tutje subjekti politik PDK, pretendon se sa i përket ngjitësit dhe formatit të shkronjave nuk janë unike, me ato që që i ka përdorur subjekti politik PDK.

## Veprimet e Ndaluarat e Subjekteve Politike

Dispozita ligjore e Nenit 33 pika (b) i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme LZP, dhe nen 3 paragrafi 1 pika (b) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, parashohin se:

*Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalojnë nga bërja e ndonjërit si në vijim:*

b) vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterave, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve.

## Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

*Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:*

c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

## Ankesa është e bazuar

PZAP-i, përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi ndaj subjektit politik për ndonjë shkelje, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore

Nga tri fotografit që gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se posterat e kandidatit për Kryetarë të Komunës së Ferizajt nga radhët e subjektit politik të PDK-së, Agim Aliu, janë të vendosura mbi shenja publike për qytetarë, e që është në kundërshtim me dispozitat e lartcekura ligjore dhe meqenëse subjekti politik PDK, shkeljet e kësaj natyre i ka përsëritur në vazhdimësi andaj konsiderohet si recidivist e cila rrethanë ndikon në lartësinë e dënimit të shqiptuar më gjobë andaj nga arsyet e lartcekura, dhe në pajtim me dispozitat e lartcekura ligjore, PZAP-i, konstaton se ankesa është e bazuar, prandaj më qëllim të evitimt të shkeljes së lartë cekur dhe në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkuesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

#### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 75/2012 më datën 30.04.2012

